



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:058076

Datë: 05.04.2024

Numri i dokumentit: 05554474

KPPP.nr.835/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbaremore të kreditorit “Agro Invest-1” SH.P.K., me NUI: 811034280, me seli në fshatin Mushtisht, Komuna e Suharekës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Asman Hoxha, avokat nga Prizreni, kundër debitorit Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bilbil Oruçi, avokat nga Rahoveci, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.103/2023 të datës 28.04.2023, të Përmbaremit Privat Mehdi Reshani me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 05.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Rahovecit, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.103/2023 të datës 28.04.2023, të Përmbaremit Privat Mehdi Reshani.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbaremore P.nr.103/2023 i datës 28.04.2023 i lejuar nga Përmbaremi Privat Mehdi Reshani.

A r s y e t i m

Përmbaremi Privat, duke vepruar sipas propozimit të autorizuarit të kreditorit “Agro Invest-1” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbaremore P.nr.103/2023 të datës 28.04.2023, me të cilin ka lejuar përmbaremin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës nr. 002/2022 të datës 02.08.2022 dhe Faturës nr. 002/2022 të datës 28.07.2022; me të cilën është detyruar debitori që menjëherë pas pranimit të urdhrit, t’ia paguaj kreditorit borxhin e mbetur të pa paguar në shumën

prej 29,105.00 €, me kamatëvonesë prej 8% vjetore, nga data e arritjes së afatit për pagesë të secilës faturë, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka deklaruar se nuk i konteston obligimet që rrjedhin nga kontrata dhe se ka obligim kontraktual për t'i paguar shërbimet, por që në rastin konkret nuk është vërtetuar kërkueshmëria e kredisë, pasi që kushti i përcaktuar në dokumentin përbarues nuk është përmbushur, për faktin se propozimi për përbarim është parashtruar para kohe, respektivisht në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Financat Publike dhe Përgjegjësitë si dhe dispozitat kontraktuale në mes të palëve ndërgjyqëse. Ka shtuar që në rastin konkret faturat e kreditorit janë të mbrojtura me statutin e kufizimeve, ngase komisioni nuk ka bashkëngjitur me fatura edhe raportin e pranimit të punëve, meqenëse ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 24 – 30 të kontratës për mënyrën e pagesave. Më tutje ka deklaruar se të dy faturat janë në numër të njëjtë rendor. Në fund ka shtuar se ka kryer një pagesë me numër të faturës nr.002/2022 me datë 04.10.2022 në shumën prej 5,210.00€, e rrjedhimisht debitori nuk ka mundur të kryej pagesa për faturat me numër të njëjtë brenda një viti fiskal. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri për përbarim, si dhe të detyrohet kreditori që t'i kompensojë shpenzimet procedurale në emër të përpilimit të prapësimin në shumën prej 312.00 €.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, duke theksuar ndër të tjera se janë përmbushur të gjitha kushtet si dhe procedurat ligjore për ekzekutimin e pagesës nga debitori, e cila deri më tani nuk janë kryer, fakt i cili pranohet edhe nga ana e debitorit. Më tutje ka shtuar se debitori ka paguar një pjesë të detyrimeve për fatura tjera ndërsa ka mbetur borxh shumën e cekur si në propozim, duke theksuar që kreditori ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore, meqenëse faturat e paraqitura janë dokumente të besueshme, pasi që janë dorëzuar në origjinal dhe janë protokolluar nga debitori.

Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj në tërësi prapësimin e debitorit, urdhri përbarimor të mbetet në fuqi dhe të obligohet debitori që të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore duke përfshirë edhe shpenzimet për avokatin.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm, i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe është janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën nr. 002/2022 të datës 02.08.2022 dhe Faturën nr. 002/2022 të datës 28.07.2022, e të cilat fatura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, sipas kontratës *“Rrënimi i objekteve pa leje në Komunën e Rahovecit”*, nr. Prokurimit: 623-21-5827-5-2-1, është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, koha e përmbushjes së këtij detyrimi si dhe të njëjtat janë bërë të arritshme për pagesë.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të

besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, mbajnë vulën e pranimit nga debitori si dhe nuk janë kundërshtuar nga debitori.

Në rastin konkret rezulton se: Fatura nr. 002/2022 në vlerë prej 13,015.00 € është lëshuar nga ana e kreditorit me datën 02.08.2022 dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga vula e pranimit e datës 04.08.2022 dhe numri i protokollit nr. 2868, si dhe Fatura nr. 002/2022 në vlerë prej 16,090.00 € është lëshuar nga ana e kreditorit me datën 28.07.2022 dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga vula e pranimit e datës 28.07.2022 dhe numri i protokollit nr. 2800.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit sa i përkeet kohës së përmbushjes së detyrimit monetar dhe gjeti se e njëjta nuk gjen mbështetje ligjore, sepse në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, për faktin se afati i përmbushjes së detyrimit është përcaktuar në faturë si dhe në kontratën ndërmjet palëve, dhe se në rastin konkret kërkesat nga dy faturat e lartcekura janë bërë të arritshme pas kalimit të afatit 30 ditor nga data e lëshimit të tyre.

Gjykata vlerësoi pretendimin e debitorit, se në rastin konkret ka paguar pjesërisht detyrimin sipas faturave kontestuese, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pa bazuar, për faktin se pagesa e kryer në emër të faturës nr.002/2022 të datës 04.10.2022, rezulton se ka të bëjë me fatura tjera të cilat nuk janë objekt shqyrtimit i kësaj çështje përmbarimore.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr 835/23, datë 05.04.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.